

Projekti Hidroenergjetik i Devollit

Devoll Hydropower Sh.A. (DHP) është një shoqëri e regjistruar në Shqipëri, pjesë e Grupit Norvegjez Statkraft. Në përputhje me një Kontratë Koncesioni, DHP është përgjegjëse për ndërtimin dhe operimin e Projektit Hidroenergjetik të Devollit përgjatë lumit Devoll, në Shqipërinë Juglindore. Marrëveshja e Koncesionit bazohet në një model BOOT (Ndërtim-Zotërim-Operim-Transferim) dhe u nënshkrua me Qeverinë e Shqipërisë në 19.12.2008, miratuar nga Parlamenti Shqiptar përmes Ligjit Nr. 10083, datë 23.02.2009, i ndryshuar.

DHP ka ndërtuar dhe operon dy hidrocentrale të mëdha (Banja dhe Moglica) me një kapacitet total të instaluar prej afërsisht 269 MW. DHP është gjithashtu tregtues i energjisë në tregun lokal dhe rajonal të energjisë.

Bazuar në Shtesën e 4-t të Kontratës së Koncesionit (Ligji nr. 83/2023), Statkraft po zhvillon një projekt të ri hidrocentrali me sistemin e rezervës së pompuar të quajtur "RP Moglica Shtesë"



Diga dhe rezervuari i HEC Moglicë

Kontakte

Devoll Hydropower Sh.A.

Zyra e Informimit të Publikut Banja
Fshati Shtepanj, Njësia Administrative Gostimë
Bashkia Cërrik, Elbasan, Shqipëri

Zyra e Informimit të Publikut Moglicë
Diga Moglicë, Fshati Maliq-Opar, Njësia Administrative Moglicë, Bashkia Maliq, Korçë, Shqipëri

Personi i kontaktit për ankesat:

Mr. Ervin Dedja
Tel.: +355 (0) 4 450 1301
Email: grievance.albania@statkraft.com

DEVOLL HYDROPOWER SH.A.

WWW.STATKRAFT.AL

Adresa:
ABA Business Centre
Rruga Papa Gjon Pali II
Ndërtesa Nr. 12, Kati Nr. 12
Zyra Nr. 1206
Njësia Bashkiake Nr. 2
Kodi Postar 1010
Tiranë, Shqipëri

Statkraft është kompani lider në hidroenergji në rang ndërkombëtar dhe prodhuesi më i madh i energjive të rinovueshme në Europë. Grupi prodhon energji nga uji, era, dielli, gazi dhe furnizon edhe ngrohje qendrore. Statkraft është kompani globale në operimet e tregut të energjisë. Statkraft ka më shumë se 6,000 të punësuar në 20 vende.

PROJEKTI HIDROENERGJETIK I DEVOLLIT

FLETËPALOSJE INFORMUESE RRETH
MEKANIZMIT TË SHQYRTIMIT TË ANKESAVE

SHTATOR 2024

Mekanizmi i Shqyrtimit të Ankesave

Devoll Hydropower Sh.A. (DHP) ka krijuar një Mekanizëm Shqyrtimi Ankesash (MSHA). Kjo është bërë për t'u siguruar se kushdo që ka ndonjë ankesë apo shqetësim rreth aktiviteteve të Projektit të DHP-së, të mund të na informojë dhe të mund të ketë një përgjigje nga ana jonë për mënyrën se si kompania do ta adresojë këtë shqetësim apo çështje. Procedura është e aplikueshme për aktivitet e kaluara dhe ato aktuale të projektit.

Ky mekanizëm është krijuar duke njohur rëndësinë e transparencës dhe përgjegjësisë. Shqetësimet dhe ankesat e personave të prekur nga projekti dhe palëve të tjera të interesuara mund të bëhen lirisht, dhe do të adresohen në një mënyrë të drejtë, objektive dhe konstruktive.

DHP do të analizojë të gjitha ankesat e paraqitura. Nëse DHP konstaton se një ankesë nuk është e lidhur me aktivitetet e DHP-së apo nëse Projekti është në përputhje me Standardet Shqiptare dhe ato Ndërkombëtare për të cilat DHP është e angazhuar, ne do jua shpjegojmë këtë me shkrim. Nëse DHP konstaton se subjekti i ankesës është rezultat i aktiviteteve të DHP-së dhe nuk përputhet me angazhimet Mjedisore dhe Sociale të DHP-së, ne do ta shqyrtojmë çështjen dhe do ju kontaktojmë për t'ju sugjeruar dhe rënë dakord në një zgjidhje të përshtatshme. DHP do ta trajtojë ankesën tuaj në mënyrë konfidenciale.



Raportimi i një Ankese

Mund të na raportoni një ankesë nëpërmjet:

- Vizitës në Zyrat tona të Informimit të Publikut në Banjë dhe Moglicë dhe plotësimit të një Formulari Ankese
- Dërgimit të një letre në zyrat tona
- Kontaktoni me DHP-në personalisht, me email apo në telefon

Ne do ju kontaktojmë për t'ju dhënë një përgjigje.

Hapat kryesore të Mekanizmit

1. REGJISTRIMI I ANKESAVE

Kur ne të regjistrujmë Ankesën tuaj, do ta procesojmë atë. Ankesat duhet të jenë me shkrim. Nëse ju do të na njoftoni verbalisht për ankesën tuaj duke ardhur te një nga Zyrat tona të Informimit, ne do ju ndihmojmë në plotësimin e formës. Pas regjistrimit, Ankesa juaj do të procesohet nëpërmjet Mekanizmit të Shqyrtimit të Ankesave.

2. PRANIMI I ANKESËS

Ankesa juaj do të pranohet me shkrim brenda 15 ditësh. Kjo kryhet për t'ju konfirmuar se Ankesa juaj është regjistruar dhe po procesohet nëpërmjet Mekanizmit të Shqyrtimit të Ankesave. Pranimi do ju informojë edhe për numrin e ankesës, personin e kontaktit, procesin dhe një afat të përafërt për zgjidhjen e ankesës.

3. ZGJIDHJA E ANKESËS

Njësitë / Komitetet e caktuara të DHP-së do të shqyrtojnë ankesën tuaj. Brenda 30 ditësh të njohjes së ankesës tuaj ne do ju kontaktojmë për t'ju dhënë zgjidhjen tonë apo për t'ju përditësuar me statusin e ankesës.

4a. APELIMI

Nëse ju nuk jeni të kënaqur me zgjidhjen e propozuar nga DHP, keni mundësinë e apelimit për rishikim të çështjes nga DHP. Ju mund ta paraqisni Ankesën lirisht në ndonjë nivel tjetër alternativ shqyrtimi jashtë DHP-së.

4b. MARRËVESHJA

Nëse ju jeni i kënaqur me shqyrtimin e bërë dhe zgjidhjen e propozuar nga DHP-ja, ne do ju kërkojmë të firmosni një deklaratë marrëveshjeje për këtë gjë. Kjo shërben për të formalizuar veprimet korrigjuese për t'u zbatuar nga DHP për zgjidhjen e Ankesës.

5. ZBATIMI I ZGJIDHJES

Pas arritjes së marrëveshjes për zgjidhjen e ankesës DHP do të zbatojë veprimet korrigjuese të rëna dakord.

Ankesa që mund të ngrini

Ju mund të ngrini një ankesë apo shqetësim në DHP nëse ju besoni se Projekti ka pasur apo ka një ndikim negativ në ju apo në familjen tuaj.

Shembuj të ankesave mund të përfshijnë, por nuk kufizohen në:

- Pasojat e projektit apo aktivitetet e tij ndikojnë negativisht jetën tuaj të përditshme
- Efekte negative te një person, shtëpi apo grup komuniteti (p.sh. humbje financiare, humbje e burimeve, dëmtime)
- Shpërdorim apo shkelje financiare
- Përpjekje për të fshehur ndonjë nga më të mësipërmet

Më shumë informacion

Informacion shtesë rreth DHP dhe projekteve të saj mund të merret pranë Zyrave të DHP-së për Informimin e Publikut në Moglicë dhe Banjë, ose në faqen e internetit të shoqërisë.

